



RAPORT PËR GJASHTËMUJORIN E PARË PËR VITIN 2025, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT

1. Përmbledhja ekzekutive (*pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë*)

Gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025, ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit ka përmbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Konkretisht, është konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP) dhe aktiviteteve të tjera konsultative:

1. Projektligji, “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”.

Konsultimet paraprake mbi projektligjin kanë zgjatur 1 (një) muaj. Konsultimet në portalin e Regjistrat Elektronik janë zhvilluar për një periudhë prej 20 ditë pune, nga data 24 janar 2025 deri më 21 shkurt 2025. Gjatë kësaj kohe, portali ka regjistruar 963 vizita dhe është marrë 1 (një) koment.

Realizimi i procesit të konsultimit publik për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2025 është 100%. Format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundësuar njohjen, mbledhjen dhe reflektimin e rekomandimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar, me qëllim hartimin dhe miratimin e nismave ligjore dhe nënligjore, të gjithëpranuara dhe që reflektojnë interesin e publikut.

Mjetet alternative të njoftimit të procesit të konsultimit, identifikimi i grupeve të interesit dhe takimet e shpeshta të organizuara ka bërë të mundur një pjesëmarrje të konsiderueshme të grupeve të interesit, por sfida mbetet rritja e reagueshmërisë dhe dhënies së komenteve nga publiku, qoftë edhe përmes identifikimit të metodave/instrumentave inovative për nxitjen e pjesëmarrjes të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025, numri i përgjithshëm i akteve të miratuara me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, është 2 (dy) akte. Më konkretisht,

1. Projektligji, “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”;
2. Projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm”.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025, është 1 (një) akt, i miratuar, i cili i është nënshtruar procesit të konsultimit publik. Ndërsa 1 (një) akt tjetër i miratuar, nuk ka qenë objekt i konsultimit publik, kjo në përputhje me parashikimet e nenit 4, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025, me raport Vlerësimi të Ndikimit Rregullator është konsultuar 1 (një) ligj i miratuar dhe më konkretisht projektligji “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”, i cili i është nënshtruar procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45, të Kreut VI, të Rregullores të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Në nenin 1, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, përcaktohet se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe për politika me interes të lartë publik. Për rrjedhojë, nga strukturat e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit është parashikuar që njoftimi dhe konsultimi publik të realizohet vetëm për projektaktet ligjore dhe nënligjore që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1, të ligjit të sipërcituar. Ndërsa, në nenin 4, të ligjit në fjalë, parashikohen kufizimet për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, duke përcaktuar natyrën e projektakteve që nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, sikurse janë projektaktet që lidhen me çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative me fuqinë e ligjit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe, emergjencat civile dhe çështje të tjera përjashtimore të parashikuara me ligj. Në këtë këndvështrim, është planifikuar për konsultim publik vetëm një projektligj, duke përjashtuar projektvendimet e tjera në përputhje me parashikimet e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Në vendimin nr. 818, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave

gjatë vitit 2025”, janë parashikuar të miratohen 13 (trembëdhjetë) akte, të cilat përjashtohen nga detyrimi për t’iu nënshtruar procesit të konsultimit publik, pasi konsiderohen si akte administrative individuale dhe akte administrativ me karakter normativ, për të cilat me ligj të veçantë nuk parashikohet ndryshe. Aktet e përjashtuara nga detyrimi për t’iu nënshtruar procesit të konsultimit publik nuk janë të parashikuara në PKIE apo me karakter strategjik kombëtar dhe sektoriale.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Akti i miratuar, objekt konsultimi publik, gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025, është 1 (një) projektligj dhe më konkretisht projektligji, “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me një vit më parë, konkretisht me konsultimin e 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2024, numri i akteve të konsultuara ka qenë më i vogël sesa një vit më parë, pra vetëm 1 (një) akt. Kjo në harmoni edhe me fushën e veprimtarisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025, ishin 6 (gjashtë):

1. Njoftimi paraprak përmes takimeve publike dhe daljeve publike në media;
2. Konsultimi në faqen zyrtare online të konsultimit publik, RENJKP;
3. Përcjellja e komenteve në rrugë shkresore postare dhe postës elektronike;
4. Komunikimi nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale;
5. Seanca të organeve këshillimore;
6. Takime publike dhe tryeza konsultimi të zhvilluara me përfaqësues institucional, të grupeve të interesit, ekspertë, aktorë kyç të sektorit financiar dhe ekonomik, me institucionet financiare kombëtare e ndërkombëtare me interes për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, me përfaqësues të sektorit bankar dhe mikrofinancës etj.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Në lidhje me aktin e miratuar, i cili është konsultuar gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025, metodat të cilat kanë gjeneruar numrin më të madh të komenteve sipas renditjes kanë qenë takimet publike dhe tryezat e konsultimeve të zhvilluara me përfaqësues institucional, të grupeve të

interesit, të botës akademike, ekspertë etj., komunikimet shkresore dhe të postës elektronike, si dhe faqja zyrtare online e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK).

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Lidhur me aktin e miratuar, i cili i është nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë 6 (gjashtë) muorit të parë të vitit 2025, është zhvilluar konsultim paraprak, që ka zgjatur 1 (një) muaj ku janë zhvilluar konsultime të brendshme me institucionet që kanë kompetenca në fushën e prekur nga projektligji, me Dhomat e Biznesit, me përfaqësues institucional, të grupeve të interesit, ekspertë, aktorë kyç të sektorit financiar dhe ekonomik, me institucionet financiare kombëtare e ndërkombëtare me interes për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, me përfaqësues të sektorit bankar dhe mikrofinancës etj.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi publik ka qenë i hapur për 20 (njëzet) ditë pune nga data e njoftimit, të kërkuara minimalisht sipas ligjit, për 1 (një) akt të miratuar, i cili i është nënshtruar këtij procesi gjatë 6 (gjashtë) muorit të parë të vitit 2025.

Më konkretisht, për projektligjin “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”, njoftimi dhe konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) u realizua në përputhje me përcaktimet e nenit 15, të ligjit. Ky konsultim elektronik u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditë pune, nga data 24.01.2025 - 21.02.2025.

Në kuadër të transparencës dhe ligjit për konsultimin publik, draftpaketa ligjore iu nënshtrua procesit të konsultimit publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP), me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga palët e interesuara në këto procese.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte 8 (tetë) muaj. Kjo përlllogaritje është bërë duke patur në vëmendje kohën (numrin e muajve) gjatë të cilës ka filluar puna për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, identifikimin e grupeve të interesit, hartimin e draftaktit, publikimin në RENJKP, zhvillimin e metodave të tjera të konsultimit, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e draftit final për projektligjin.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku numri i akteve të konsultuara ka qenë më i lartë, në 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2025, për shkak se rezulton vetëm një akt i konsultuar dhe i miratuar, situata vlerësohet se është stabile.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Për hartimin e aktit të miratuar, i cili i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, kanë marrë pjesë 4 (katër) aktorë të jashtëm joqeveritar, të cilët kanë ofruar ekspertizën e tyre pranë grupit ndërinstitucional të punës. Ndërsa, në organet këshillimore kanë marrë pjesë 7 (shtatë) aktorë të jashtëm joqeveritar, si anëtarë të strukturës së posaçme pranë grupit ndërinstitucional të punës.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për hartimin e akteve të miratuara, të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, kanë kontribuar si anëtarë të jashtëm të grupeve të punës, ekspertë individual ligjor të përzgjedhur nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si dhe nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP).

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projektaktet në vitin e caktuar?

Në konsultimet e hapura të realizuara për projektaktet e miratuara, gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025 kanë marrë pjesë 50 (pesëdhjetë) palë të interesuara joqeveritare. Në këtë kuadër, 3 (tre) palë të interesuara joqeveritare dërguan komente dhe reagime për projektligjin, “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Projektligji është hartuar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 168, datë 28.08.2024, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektligjit për krijimin e një institucioni me qellim nxitjen e financimit dhe zhvillimit ekonomik” të ndryshuar, i kryesuar nga ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesi dhe i përbërë edhe nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Departamentit të Administratës Publike dhe Postës Shqiptare Sh.A. Në aspektin teknik, ky grup ka pasur mbështetjen e një strukture të përbërë nga ekspertë të pavarur me njohuri të thelluara në fusha si juridike, financiare, bankare dhe burimet njerëzore. Procesi i hartimit është realizuar gjithashtu nëpërmjet takimeve dhe

diskutimeve me përfaqësues të institucioneve si Banka e Shqipërisë, si dhe me mbështetjen e ekspertizës së ofruar nga Cassa Depositi e Prestiti.

Projektligji është përcjellur për shqyrtim dhe komente pranë institucioneve përkatëse, përfshirë Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Departamentin e Administratës Publike, SASPAC, Postën Shqiptare Sh.A., Agjencinë e Prokurimit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

Në kuadër të konsultimeve publike për projektligjin “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit” janë organizuar 3 (tre) takime në ambientet e Shtëpisë së Biznesit, me pjesëmarrjen e aktorëve kyç të sektorit financiar dhe ekonomik. Përkatësisht,

- Më 5 shkurt 2025, është zhvilluar një takim me Institucionet Financiare Ndërkombëtare, ku morën pjesë përfaqësues nga Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe institucione të tjera me interes për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Diskutimet u fokusuan në standardet ndërkombëtare për bankat zhvillimore dhe integrimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit në këtë ekosistem;
- Më 6 shkurt 2025, është mbajtur një takim me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Shoqatat e Biznesit;
- Më 7 shkurt 2025, është zhvilluar një takim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, Shoqatën e Mikrokredisë dhe përfaqësues të sektorit bankar dhe mikrofinancës. Diskutimet u përqendruan në ndikimin e mundshëm të bankës në ekosistemin financiar, mekanizmat e bashkëpunimit me bankat tregtare dhe sigurimin e konkurrencës së ndershme.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP), ku u konsultua projektligji, u gjenerua vetëm 1 (një) koment nga një personë fizik, një fakt që vjen në ulje në krahasim me komentet e dërguara vitin e kaluar. Por vlen të theksohet fakti se publikimi i projektligjit është bërë në respektim të plotë të rregullave të përcaktuara nga ligji nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe palët e interesuara, kanë patur mundësinë të dërgojnë komentet apo sugjerimet e tyre para miratimit të projektligjit. Kjo vërtetohet lehtësisht edhe nga numri relativisht i lartë i klikimeve në rubrikën e projektaktit të publikuar në RENJKP (963 klikime e vizita).

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Gjatë 6 (gjashtë) muorit të parë të vitit 2025, numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej ka qenë 23 (njëzet e tre), ku më konkretisht në konsultimin e projektligjit “Për Bankën

Shqiptare të Zhvillimit”, 1 (një) koment është paraqitur në faqen elektronike të konsultimit publik në RENJK dhe 22 (njëzet e dy) janë parashtruar në kuadër të tryezave e takimeve publike, si dhe me shkrim.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Për 1 (një) projektakt të konsultuar dhe të miratuar gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2025, numri total i komenteve të pranuar plotësisht është 11 (njëmbëdhjetë); të refuzuara është 9 (nëntë) dhe të pranuar pjesërisht është 1 (një).

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Tendenca e pranimi të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, mbetet në rritje, trend i pasuar që nga viti 2024.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Një raport VNR-je është ndryshuar dhe përditësuar në bazë të informacionit dhe komenteve të marrë gjatë konsultimit publik.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2025, ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit ka hartuar dhe publikuar në portalin e regjistrat elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK) raportin e konsultimit për 1 (një) projektakt dhe më konkretisht:

1. Raport konsultimi për projektligjin “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2025, ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit ka hartuar dhe publikuar raportin e konsultimit për aktin e miratuar, i cili iu nënshtrua procesit të konsultimit publik.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Bazuar në vetëvlerësimin institucional në lidhje me indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit vlerëson se konsultimi i projektaktit ka qenë në nivel shumë të mirë, duke performuar me pikëzim cilësie për aktin e konsultuar si vijon:

1. Projektligji “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit” - vetëvlerësimi 8 (tetë).

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet qartësisht një kulturë e përhapur dhe e gjerë i angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Pavarësisht përpjekjeve dhe mundësive të ofruara nga ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, ende nuk ka një përfshirje shumë të gjerë dhe aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen.

Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Gjithashtu, vlerësohet se edhe angazhimi nëpërmjet rrjeteve sociale duke u realizuar edhe në kombinim me metodat e tjera të konsultimit publik do të sjellë rritje të përfshirjes dhe mundësive në këtë kuadër.